



Komercijalna banka
AD Skopje

MARRËVESHJE Për llogari rrjedhëse të personit juridik – jorezident

E lidhur në Shkup më datë _____, midis:

1. Komercijalna banka AD Skopje (në tekstin e mëposhtëm: Banka), e përfaqësuar nga Vesela Çurillova, Drejtor i Sektorit për marrëdhëniet me jashtë dhe
2. _____ (në tekstin e mëposhtëm: Posedues i llogarisë) i/e përfaqësuar nga _____

Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

Me këtë Marrëveshje rregullohen të drejtat e ndërsjellta, detyrimet dhe përgjegjësitë ndërmjet palëve, që dalin nga hapja, udhëheqja dhe puna me llogari rrjedhëse të transaksionit në valutë dhe/ose llogari në denarë për shkak të realizimit të qarkullimit pagesor, përkatësisht pagesës nga transaksionet me rezidentë, transferim të mjeteve me rezident, si dhe pagesa në valuta efektive dhe para vendore, në përputhje me rregullat ligjore dhe nënligjore.

Neni 2

Shërbimet lidhur me hapjen, udhëheqjen, punën dhe mbylljen e llogarisë dhe qarkullimit pagesor, Banka i kryen në përputhje me këtë Marrëveshje, Kushtet e përgjithshme për hapjen dhe punën me llogaritë rrjedhëse të personave juridik – jorezident të Komercijalna banka AD Skopje (në tekstin e mëposhtëm: Kushtet e përgjithshme), rregullat ligjore dhe nënligjore, aktet e politikës afariste të Bankës dhe dokumentet tjera që janë pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje.

Hapja e llogarisë

Neni 3

Në bazë të kësaj Marrëveshjeje, Banka hap llogari rrjedhëse të transaksionit në valutë dhe/ ose denarë të Poseduesit të llogarisë nr. _____, nëpërmjet të cilës Poseduesi i llogarisë do të kryej pagesa nga transaksionet me rezidentët, transferime të mjeteve nga jorezidentët si dhe të bëjë pagesa dhe të pranojë pagesa para efektive në valutë dhe para vendore në përputhje me rregullat ligjore dhe nënligjore.

Neni 4

Me nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje, Poseduesi i llogarisë vërteton se i është dhënë një kopje dhe se është i njohur dhe i pranon:

- Kushtet e përgjithshme për hapjen dhe punën me llogaritë rrjedhëse të personave juridik-jorezident të Komercijalna banka AD Skopje dhe
- Fragment nga Vendimi për tarifën e kompensimeve për shërbimet që i kryen Banka, ku janë theksuar të gjitha shpenzimet dhe provizionet lidhur me punën e llogarisë dhe
- dokumentet tjera që rregullojnë punën me llogarinë.

Neni 5

Dokumentacioni i përgjithshëm i cituar në Nenin 4 të kësaj Marrëveshjeje përfaqëson pjesë nga marrëveshja.

Neni 6

Poseduesi i llogarisë dhe Banka obligohen që gjatë kryerjes së qarkullimit pagesor me jashtë do t'i respektojnë rregullat e vlefshme ligjore dhe nënligjore, Kushtet e përgjithshme, Marrëveshjen dhe aktet tjera dhe dokumentet me të cilat rregullohet qarkullimi pagesor dhe mënyra e hapjes, udhëheqja dhe mbyllja e llogarive.

Neni 7

Banka Poseduesit të llogarisë, i jep kartonë për nënshkrim, me të cilin poseduesi i llogarisë cakton persona të autorizuar, të cilët do të disponojnë me mjetet nga llogaria për shkak të mbrojtjes së interesave të tij, Poseduesi i llogarisë është i obliguar me kujdes t'i ruajë dhe përdorë kartonët e nënshkruar.

Banka nuk mban asnjë lloj përgjegjësie për dëmin material apo çfarëdo lloj dëmi të tjerë, i cili mund të ndodhë për Poseduesin e llogarisë si rezultat i ruajtjes dhe përdorimit të papërgjegjshëm dhe të pakujdesëshëm të **kartonëve nënshkrues**.

Neni 8

Poseduesi i llogarisë obligohet që për çdo ndryshim të personave të autorizuar, ose të dhënave themelore të personit juridik - jorezident menjëherë ta njoftojë Bankën.

Për shkak të nevojës së azhurimit të dokumentacionit në Bankë Poseduesi i llogarisë është i obliguar njëherë në dy vjet ti prezantojë bankës dokumentacionin adekuat në përputhje me rregullat ligjore dhe nënligjore, dhe aktet e Bankës.

Për dëmin eventual të ndodhur për shkak të njoftimit jo të rregullt dhe në kohë nga ana e Poseduesit të llogarisë, Banka nuk mban asnjë përgjegjësi.

Mënyra e realizimit të qarkullimit pagesor me jashtë

Neni 9

Poseduesi i llogarisë është i obliguar të dërgojë urdhërpagesa të sakta dhe të plotësuara në mënyrë të rregullt. Banka nuk mban asnjë përgjegjësi për dëmin eventual të ndodhur për Poseduesin e llogarisë për shkak të dhënave gabimisht të shënuara në urdhëresa.

Banka e njofton Poseduesin e llogarisë për parregullsi dhe jokompletimin e urdhërpagesave të plotësuara gabimisht.

Përlllogaritja e normës së interesit

Neni 10

Mjetet e llogarisë janë mjete në të parë me të cilat Poseduesi i llogarisë disponon në çdo kohë.

Për mjetet në llogari, banka llogaritë normë interesi në përputhje me Vendimin për normat e interesit në fuqi të Bankës në ditën e llogaritjes. Norma e interesit e llogaritur përshkruhet në gjendjen e llogarisë.

Neni 11

Poseduesi i llogarisë mund të dorëzojë kërkesë me shkrim deri te Banka për afatizimin e mjeteve të llogarisë së tij për periudhë të caktuar kohore, në përputhje me Vendimin për normat e interesit të Bankës. Për afatizimin e mjeteve lidhet Marrëveshje e veçantë ndërmjet Bankës dhe Poseduesit të llogarisë, ku më afër rregullohen marrëdhëniet e ndërsjellta të palëve, që dalin nga afatizimi.

Pagesa e kompensimit

Neni 12

Për realizimin e shërbimeve lidhur me qarkullimin pagesor dhe punën me llogarinë, Banka faturon kompensim për lartësinë, afatet dhe në mënyra të përcaktuara me Vendimin në fuqi për tarifën e kompensimeve për shërbimet që i realizon Banka të vlefshme në ditën e realizimit të shërbimeve.

Neni 13

Për të gjitha shërbimet dhe shpenzimet lidhur me qarkullimin pagesor dhe të gjitha kërkesat e Bankës, të cilat mund të ndodhin gjatë punës me llogarinë, Poseduesi i llogarisë e autorizon Bankën, pa pajtimin e tij plotësues të krijojë urdhëresë dhe ta ngarkojë llogarinë e tij të bërë në përputhje me këtë Marrëveshje.

Shitblerja e valutave sipas urdhëresës së Poseduesit të llogarisë, realizohet sipas kursit blerës dhe shitës që është në fuqi në momentin e realizimit të transaksionit.

Poseduesi i llogarisë realizon inspektim të të gjitha borxheve të llogarisë, që kanë për bazë kompensimet dhe shpenzimet, të cilat i paguan Banka, nëpërmjet inspektimit të ndryshimeve në Raportin e llogarisë.

Njoftime

Neni 14

Poseduesi i llogarisë obligohet ta njoftojë Bankën për të gjitha ndryshimet e statusit, ndryshimet e nënshkruesve të autorizuar, të dhënat e adresës dhe të gjitha informacionet tjera, që i ka dhënë gjatë lidhjes së kësaj Marrëveshje, menjëherë ose më së voni në afat prej tri ditëve nga dita e ndryshimit.

Poseduesi i llogarisë merr tërë përgjegjësinë për çfarë do qofshin pasoja, që mund të ndodhin si rezultat i mos njoftimit në kohë të ndryshimeve relevante.

Neni 15

Për gjendjen dhe ndryshimet e ndërhura në llogari, Banka e njofton Poseduesin e llogarisë për dorëzimin e raportit të ndryshimeve dhe gjendjen e llogarisë, në mënyrën e përcaktuar nga Poseduesi i llogarisë.

Me dorëzimin ose marrjen e raportit, Poseduesi i llogarisë konsiderohet se është njoftuar me të gjitha ndryshimet si në llogarinë e tij ashtu edhe me punën e Bankës.

Neni 16

Poseduesi i llogarisë është i detyruar ta kontrollojë saktësinë e raporteve dhe nëse vëren parregullsi, në afat prej tetë ditëve që nga lëshimi i raportit të dorëzojë parashtresë deri te Banka. Banka përgjigjet lidhur me parashtresën në afat prej dy ditëve nga dita e pranimit të parashtresës.

Neni 17

Banka e mban të drejtën që të kryejë ndryshime në vëllimin dhe përmbajtjen e llojeve të caktuara të shërbimeve dhe kushteve të bashkëpunimit afarist të rregulluara me Kushtet e përgjithshme, Marrëveshjen, Vendimin për tarifën e kompensimeve për shërbimet që i kryen Banka, Vendimet për normat e interesit, aktet e politikës afariste të Bankës dhe dokumentet tjera, të cilat e rregullojnë punën me llogarinë dhe për këtë e njofton Poseduesin e llogarisë nëpërmjet publikimit të informatës në raportin e llogarisë së tij, ose ueb faqen e Bankës.

Neni 18

Palët pajtohen se e rregullt do të konsiderohet dërgesa e realizuar në adresën e fundit të lajmëruar nga Poseduesi i llogarisë në Bankë.

Neni 19

Në qoftë se Poseduesi i llogarisë nuk pajtohet me ndryshimet e caktuara në punën e llogarisë mund të paraqesë vërejtje me shkrim ose kërkesë për ndërprerjen e Marrëveshjes brenda 15 ditëve pas përfundimit të muajit në të cilin informacioni është publikuar, në të kundërtën konsiderohet se ai pajtohet me ndryshimet e propozuara dhe të njëjtët bëhen pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje.

Mbrojtja e të dhënave

Neni 20

Banka në pajtueshmëri me rregullat ligjore të vlefshme, obligohet të sigurojë diskrecion dhe t'i mbrojë të dhënat e punës me llogarinë. Të dhënat për punën e llogarisë mund t'i dërgohen vetëm Poseduesit të llogarisë, organit të autorizuar në përputhje me ligjin, ose personave të tretë në bazë të pajtueshmërisë së Poseduesit të llogarisë.

Neni 21

Të dyja palët obligohen se në fshehtësi do t'i ruajnë të gjitha të dhënat dhe informatat për të cilat kanë njohuri në lidhje me realizmin dhe kohëzgjatjen e kësaj Marrëveshjeje, si dhe pas prishjes ose anulimit të saj, përveç asaj që është përshkruar me rregullat në fuqi ose nuk merren vesh në mënyrë tjetër.

Neni 22

Banka do të sigurojë mbrojtje të të dhënave personale për personat e autorizuar në përputhje me rregullat ligjore. Të dhënat personale do të përdoren vetëm për nevojat e punës me llogarinë, në bazë të pajtueshmërisë së subjekteve të të dhënave personale dhe në raste dhe mënyrën e paraparë me ligj ose rregull tjetër.

Neni 23

Poseduesi i llogarisë është i detyruar për shkak të mbrojtjes së interesave të tij t'i mbrojë të gjitha të dhënat që lidhen me llogarinë dhe kartonët nënshkrues.

Vlefshmëria dhe ndërprerja e Marrëveshjes

Neni 24

Kjo Marrëveshje lidhet për periudhë të pacaktuar kohore. Secila nga palët mund ta prishë marrëveshjen nëpërmjet njoftimit me shkrim dërguar deri te pala tjetër me afat anulimi prej 30 ditëve dhe pas përfundimit paraprak të të gjitha obligimeve që dalin nga kjo Marrëveshje.

Banka ka të drejtë që në mënyrë të njëanshme ta prishë Marrëveshjen dhe pa afat anulimi, nëse Poseduesi i llogarisë sillet në kundërshtim me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje dhe kushtet e përshkruara.

Në rast të prishjes së Marrëveshjes, ose mbylljes së llogarisë në përputhje me rregullat ligjore dhe nënligjore, ose aktet e brendshme të Bankës, Banka do t'i transferojë mjetet nga llogaria në llogari tjetër të personit juridik-jorezident, në bankë vendore ose të huaj, në përputhje me instruksionet e dhëna nga Poseduesi i llogarisë ose në përputhje me vendimin e organit përgjegjës të Bankës.

Dispozitat tjera

Neni 25

Banka nuk përgjigjet për ndërprerjen e shërbimeve të lidhura me realizimin e qarkullimin pagesor me jashtë dhe pasojat nga ndërprerja, që është jashtë kontrollit të Bankës, përkatësisht që është pasojë e fuqisë madhore dhe rrethanave, të cilat nuk ka qenë e mundur të parashikohen, pengohen, mënjanoen ose shmangen.

Neni 26

Nëse ndodhin ndryshime në rregullat ligjore që e rregullojnë punën me llogarinë dhe qarkullimin pagesor me jashtë, Banka do t'i zbatojë ligjet e reja dhe dispozitat, të cilat do të hyjnë në fuqi në kohën e vlefshmërisë së kësaj Marrëveshje. Nëse ndryshimet e tilla nuk janë adekuate me interesat e Poseduesit të llogarisë, ai ka të drejtë ta prishë Marrëveshjen në afat prej 15 ditëve nga dita e hyrjes në fuqi të ndryshimeve.

Neni 27

Termat në këtë Marrëveshje janë përdorur enkas dhe me qëllim të kuptimit më të mirë të saj dhe nuk do të zbatohen dhe interpretohen në interpelancën ose shfrytëzimin e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 28

Për gjithçka që nuk është paraparë në këtë Marrëveshje vlejné dispozitat ligjore dhe aktet e politikës afariste të Bankës.

Neni 29

Në rast të kontestit, kompetente është Gjykata e Shkupit.

Neni 30

Marrëveshja është përpiluar në katër kopje identike (dy në gjuhën angleze dhe dy në gjuhën maqedonase), nga dy kopje (njëra në gjuhën maqedonase dhe njëra në gjuhën angleze), për secilën palë.

Neni 31

Marrëveshja është lidhur dhe hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga të dy palët.

POSEDUESI I LLOGARISË

BANKA

KY DOKUMENT ËSHTË VALID VETËM NËSE ËSHTË I PLOTËSUAR, NËNSHKRUAR DHE I DORËZUAR NË GJUHËN MAQEDONASE